



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

**REZULTATI I SHORTIT TË HEDHUR
PËR ZGJEDHJEN E
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (2022)**

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, në zbatim të plotë të detyrimeve Kushtetuese dhe ligjore, zhvilloi sot në datë **3 dhjetor 2021, ora 11:00** shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili e ushtron detyrën me një mandat një vjeçar. Mandati i këtij Këshilli ushtrohet prej datës **1 janar 2022 deri në 31 dhjetor 2022**.

Shorti u hodh në prani të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, zoti Enio Haxhimihali, i cili monitoroi procesin, dhe përfaqësuesve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, zoti Gent Ibrahim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku, Gjykata Kushtetuese, zoti Aleksandër Toma, Kuvendi i Shqipërisë përmes përfaqësuesit të Kryetarit të Kuvendit zonja Merita Qato, dy anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore, zonja Dhurata Çupi dhe zoti Klevis Xhoxhi, në prani të këshilltares ligjore rezidente pranë OPDAT, zonja Michelle Lakomy dhe Klodiana Vogli specialiste ligjore OPDAT, si dhe dy përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, Zëvendës Drejtor i Seksionit Politik, të Delegacionit të Bashkimit Europian, zoti Jean-Baptiste Le Bras dhe zonja Tidita Fshazi.

Në përfundim të hedhjes së shortit rezultoi se anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë vitit 2022 janë:

- 1. Marsida Xhaferllari** nga Gjykata Kushtetuese
- 2. Elsa Toska** nga Gjykata Kushtetuese
- 3. Sokol Binaj** nga Gjykata e Lartë
- 4. Anila Leka** nga Prokuroria e Përgjithshme
- 5. Edlira Petri** nga Gjykatat e Apelit
- 6. Enton Dhimitri** nga Gjykatat e Apelit
- 7. Arta Marku** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
- 8. Etien Kapo** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
- 9. Klodiana Mema (Veizi)** nga Gjykatat Administrative

Anëtarët Zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të zgjedhur me short me të njëjtën procedurë, janë si më poshtë:

- 1. Altin Binaj** nga Gjykata Kushtetuese

2. **Sandër Simoni** nga Gjykata e Lartë
3. **Thoma Jano** nga Prokuroria e Përgjithshme
4. **Ridvan Hado** nga Gjykata e Apelit
5. **Genti Xholi** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
6. **Erarbër Madhi** nga Gjykatat Administrative

Procedura e shortit filloi në orën 11:00 dhe përfundoi në orën 12:05.

Tiranë, 3 dhjetor 2021, ora 12:05.

**MIRATOI
PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

ILIR META

Sekretari Teknike

Xhesiana Vathi
Andi Hasani
Sindi Xhuglini